



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
Drejtoria e Çështjeve Juridike

Nr. 16/1 Prot

Tiranë, më 13/01/2015

Lënda: *Jepet mendim mbi draft Dokumentin e Politikave për Sigurinë Kibernetike, si dhe anekset përkatëse.*

Drejtuar: **Znj. Milena HARITO**
MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN
PUBLIKE

Tiranë

E nderuar znj. Harito,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.27 Prot, datë 05.01.2015, draft Dokumenti i Politikave për Sigurinë Kibernetike, si dhe anekset përkatëse, vlerësohen konform kërkesave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Ndërkohë, sugjerojmë që në të gjithë dokumentet ku përdoret akronimi KMDP/IDP të ndryshohet në KDIMDP- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në “Draft Dokumentin e Politikave Për Sigurinë Kibernetike”, paragrafi i fundit i faqes nr.8, është i paqartë në përmbajtje. Konkretisht, të plotësohet fjalia në pjesën e pikëzuar, “*Incidentet e sigurisë që ndikojnë në funksionimin e duhur të rrjeteve, sistemeve dhe shërbimeve që ndërhyjnë në privatësinë e komunikimit është e nevojshme të tilla nëpërmjet Ekipeve për Reagim ndaj Emergjencave Kompjuterike*”.

Në paragrafin e parë të faqes 14, “Mbrojtja e të dhënave..”, në fjalinë “Çdo ndarje informacioni për qëllime të sigurisë kibernetike, kur përfshin të dhënat personale,..”, sugjerojmë të sqarohet togfjalëshi “*ndarje informacioni*”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

